



Revista prestigjoze Forbes ka publikuar listën e 400 personave më të pasur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lista hapet me shefin e Microsoft, Bill Gates i cili zotëron një pasuri prej 59 bilion dollarësh, mbyll 10-en e parë, Alice Walton me një pasuri që kap shifrën e 20.9 bilion dollarëve.

I vetmi person ndër 20 të parët, pasuria e të cilit ka shënuar rënie gjatë një viti, është vendi i dytë në listë, Warren Buffett. Pasuri e tij ka rënë me 6 bilion. Aktualisht, pronari i kompanisë Berkshire Hathaway zotëron një pasur prej 39 bilion dollarësh. Hendeku mes Buffet dhe mikut të tij Bill Gates është thelluar teper gjate ketij viti.

Në vendin e tretë të listës së Forbes, renditet pronari i kompanisë Oracle, Larry Ellison me një pasuri prej 33 bilion dollarësh.

FORBES| 10 më të pasurit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Bill Gates 59 b

Warren Buffett 39 b

Charles Koch 25 b

David Koch 25 b

Christy walton & family 24.5 b

George Soros 22 b

Sheldon Adelson 21.5 b

Jim Walton 21.1 b

Alice Walton 20.9 b

/Gazetajone/